



Bazuar në nenin 44 të Ligjit për Policinë e Kosovës, Nr. 04/L-076, në Rregulloren (MPB) Nr.02/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës, Udhëzimin Administrativ 02/2023 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, neni 26, si dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 06.11.2024 me nr ref: DBN 10/1-01/153/2024, Policia e Kosovës shpall:

Datë: 13.11.2024

K O N K U R S

Referenca: 10/1-01/SRS/1674/2024

Për plotësimin e vendeve të punës

1. **Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Lartë për përkthime (shqip serbisht dhe anasjelltas)**

Vendi i punës:

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë, shtatë (7) pozita,
- Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë dy (2) pozita,
- Stacioni Policor Lipjan një (1) pozitë,
- Stacioni Policor Graçanicë një (1) pozitë,
- Stacioni Policor Obiliq një (1) pozitë,
- Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovica Jugu një (1) pozite,
- Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë dy (2) pozita,
- Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren, një (1) pozitë,
- Stacioni Policor në Dragash një (1) pozitë,
- Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj një (1) pozitë,
- Stacioni Policor në Shtërpce një (1) pozitë,
- Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovica Veri dy (2) pozita,
- Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë dy (2) pozita.

Klasa: Profesional I

Koeficienti: 5.7

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të pa caktuar

Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përkthim profesional i materialeve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;
- Përkthen materiale të natyrës konfidenciale apo të ndjeshmërisë së lartë;
- Përkthim simultan nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, në takime të niveleve të ndryshme;
- Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në atë serbe, në takime të niveleve të ndryshme, Komisione, grupe pune, takime;
- Bashkëpunon me zyrtarët/përkthyesit tjerë për përmbushjen e detyrave;

- Përgjegjës që të jetë në rrjedha me kohën në çështje të avancimit të shërbimeve për përkthim me shkrim dhe simultan;
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
- Raporton rregullisht te mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi dhe shkathtësitë për të gjitha pozitat e kërkuara:

- Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite adekuate të studimeve;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në klasën Profesional 2;
- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë;
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

2. Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Lartë për përkthime (shqip anglisht dhe anasjelltas)

Vendi i punës:

– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë një (1) pozitë

Klasa: Profesional I

Koeficienti: 5.7

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të pa caktuar

Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përkthim profesional i materialeve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas;
- Përkthen materiale të natyrës konfidenciale apo të ndjeshmërisë së lartë;
- Përkthim simultan nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas, në takime të niveleve të ndryshme;
- Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas, në takime të niveleve të ndryshme, Komisione, grupe punese, takime;
- Bashkëpunon me zyrtarët/përkthyesit tjerë për përmbushjen e detyrave;
- Përgjegjës që të jetë në rrjedha me kohën në çështje të avancimit të shërbimeve për përkthim me shkrim dhe simultan;

- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
- Raporton rregullisht te mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi dhe shkathtësitë për pozitën e kërkuar:

- Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite adekuate të studimeve-diplomë e fakultetit të gjuhës Angleze;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në klasën Profesional 2;
- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë;
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kërkesat e përgjithshme për pranim janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës,
- Te ketë integritet personal dhe vlera te larta etike,
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimiit.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- a) Formulari për aplikim se bashku me Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolice.com;
- b) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës të notifikuar;
- c) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- d) Çertifikata /ekstraktin e lindjes;
- e) Çertifikata e gjendjes penale;
- f) Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- g) Një fotografi të formatit (5 x 5);
- h) Dokumentet nga pika **d** dhe **e** duhet të jenë të vlefshme (jo me i vjetër se 6 muaj)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet.

Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë. Kandidatët që kalojnë testin me shkrim do t'i nënshtrohen intervistës. Këto pozita i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Kandidatët të cilët kanë ndonjë vërejtje në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit për çdo fazë të testimit, kanë të drejtë të ankohen.

Informimi i kandidatëve lidhur me rezultatet do të publikohet në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolice.com, te rubrika mundësi e punësimit.

Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data **14.11.2024** deri me **29.11.2024**.

Mënyra e aplikimit:

Formularët duhet t'i dorëzohen në Sektorin për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. “Luan Haradinaj”, 10000 Prishtinë, Sektori për Rekrutim dhe Seleksionim, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolice.com ku gjendet shpallja e konkursit.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038-5080 lokali: 1002 /038-504504 lokali:1751dhe 038 245 184.

“Policia e Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe personat me aftësi të kufizuara”.